



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

AC-I-22-0551-A0001

Në çështjen juridike të:

M Sh, Kragujevc-Serbi i përfaqësuar nga Projekti i Ndhmës Juridike, Graqanicë.

Paditësi/ankuesi

Kundër:

Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKP), Rr. "Dritan Hoxha" nr. 55, Lakrishtë- Prishtinë.

E paditura

Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJSK), i përbërë nga Mr. Sc. Sahit Sylejmani gjyqtar kryesues, Sabri Halili dhe Ilmi Bajrami gjyqtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit të parashtruar kundër Aktgjykimit të Shkallës së parë të DHPGJSK-së C-IV.-13-2749, të datës 05 gusht 2022, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 07 dhjetor 2023, lëshon këtë:

A K T G J Y K I M

1. **Ankesa e paditësit refuzohet si e pa bazuar.**
2. **Vërtetohet Aktgjykimi i Shkallës së parë të DHPGJSK-së C-IV.-13-2749 i datës 05 gusht 2022.**
3. **Nuk caktohen taksa gjyqësore për këtë procedurë ankimore.**

Rrethanat faktike dhe procedurale:

Më 31 dhjetor 2013, paditësi kishte parashtruar ankesë në DHPGJSK kundër Vendimit të Autoriteit të Likudimit NSH "Eximkos", e administruar nga AKP (AL i AKP-së) PRN 092-0032 të datës 09 tetor 2013. Më këtë vendim ishte refuzuar kërkesa për kompensimin e pagave të pa paguara në shumën 18.000.00 euro, si e pa vlefshme, me arsyetimin se kërkesa është parashtruar konform nenit 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar (LPB).

Paditësi ka kërkuar që ky vendim të rishikohet nga gjykata, pasi që e paditura i ka mbetur borxh për pagat e pa paguara. Paditësi konsideron se më 02 shkurt 2006, përmes Zyrës së Bashkimit Evropian në Beograd, para periudhës së likudimit të datës 13 shtator 2007, andaj interpretimi se kërkesa është ushtruar para kohës dhe vlerësimi se kërkesa nuk është ushtruar brenda periudhës për dorëzimin e kërkesave tek AL i AKP-së, nuk ka bazë juridike sipas nenit 35 paragrafi 3 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së për refuzimin e kërkesës, dhe se ky vlerësim është i gabuar.

Paditësi pretendon se në momentin e dorëzimit të kërkesës në Zyrën e Bashkimit Evropian për AKM-në më datë 02 shkurt 2006, ajo i është drejtuar AKM-së, dhe se AKM nuk e ka njoftuar paditësin në lidhje me kërkesën e tij dhe nuk e ka njoftuar në lidhje me fillimin e procedurës së likudimit. Për këto arsye, paditësi mendon se me këtë rast janë cënuar të drejtat elementare të tij konform Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe i referohet disa rasteve, që i konsideron të ngjashme nga Gjykata Evropiane për të Drejtat e Liritë e Njeriut. Paditësi ka propozuar që të anulohet vendimi i kundërshtuar i AL të AKP-së dhe lënda të kthehet në rishqyrtim, ose të merret vendim nga ky kolegji dhe të aprovohet kërkesa e tij në tërësi si e bazuar në shumën prej 18.000,00 euro në emër të pagave të pa paguara nga viti 1999 deri në vitin 2006.

Më 18 gusht 2014, e paditura kishte dorëzuar mbrojtëjn ndaj padisë/ankesës së paditësit, me të cilën propozon që të refuzohet ankesa si e pa bazuar dhe të vërtetohet vendimi i kundërshtuar i AL të AKP-së. AKP thekson se janë bërë dy lajmërime për fillimin e procesit të likuidimit, më 08 qershor 2007 dhe kërkesa duhej të dorëzohej më së largu deri më 13 gusht 2007 ndërsa njoftimi i dytë është publikuar më 12 qershor 2007, derisa paditësi kërkesën e vet e kishte parashtruar më 02 shkurt 2006 në Zyrën e BE-së në Beograd.

Paditësi nuk ka ushtruar kërkesë gjatë periudhës së dorëzimit të kërkesave kreditore prej datës 08 qershor 2007 deri më 13 gusht 2007 që ka qenë afati për dorëzimin e kërkesave.

Më 05 gusht 2022, Shkalla e parë e DHPGJSK-së kishte marrë Aktgjykimin C-IV.-13-2749 me të cilin e kishte refuzuar ankesën e paditësit si të pa bazuar dhe kishte vërtetuar vendimin e kundërshtuar të AL të AKP-së si të drejtë dhe të bazuar në ligj. Shkalla e parë kishte konstatuar se paditësi me ushtrimin e ankesës nuk ka dorëzuar listën për kompensim të pagave të pretenduara në lartësinë e kërkuar, nuk ka provuar shumën mujore dhe lartësinë e pretenduar 18.000.00 euro, sikundër nuk ka sqaruar bazën juridike të kërkesës, për pagat e pretenduara. Gjykata kishte konstatuar se kërkesa nuk ishte parashkruar në tërësi, si ☀

pretendon AKP. Kërkesat e arritura për pagesë të pagave të pretenduara deri më 01 shkurt 2003 kanë qenë të parashkruara, ndërsa kërkesa për periudhën prej datës 02 shkurt 2003 deri në vitin 2006 nuk janë parashkruar. Sipas shkallës së parë paditësi nuk e ka vërtetuar me asnjë provë të vetme shumën e kërkuar, sikundër edhe nga cila bazë juridike obligohet e paditura ta kompensoj paditësin.

Shkalla e parë ka konstatuar se paditësi nuk ka dorëzuar prova, andaj kërkesa e tij është refuzuar si e pa bazuar përkundër faktit se kërkesa nuk ishte parashkruar për periudhën nga data 02 shkurt 2003.

Më 28 shtator 2022, paditësi/ankuesi kishte parashtruar ankesë kundër këtij aktgjykimi, për shkak të të gjitha bazave ankimore, duke propozuar që të aprovet ankesa e tij si e bazuar, të anulohet aktgjykimi i ankimuar dhe çështja të kthehet në rigjykim, apo të ndryshohet ky aktgjykim dhe të pranohet kërkesa e paditësit në tërësi. Ankuesi konsideron se aktgjykimi i atakuar është i pa qartë dhe kontradiktor, sepse sipas arsyesimit të këtij aktgjykimi thuhet se provat dhe faktet e paraqitura nuk e dëshmojnë bazueshmërinë e ankesës dhe pretendimet e paditësit, pasi që, sipas ankuesit, ato nuk janë shqyrtuar fare. Ankuesi pretendon se faktet vendimtare janë se paditësi ka qenë në marrëdhënie pune në NSH dhe se marrëdhënia e punës nuk është ndërprerë asnjëherë. Ankuesi nuk e ka të qartë se me cilat fakte është dashur që t'ia vertetoj gjykatës aspektin e vlefshmërisë së kërkesës së tij pagat e pa paguara nga punëdhënësi. Ankuesi ka theksuar se punësimi i të gjithë punëtorëve kishte përfunduar me hapjen e likudimit të NSH-së dhe është krejt normale dhe e bazuar që ai kishte ngritur padi për pagat e pa paguara.

Ankuesi thekson se LPB i cili ishte në fuqi në atë kohë, përcakton qartë procedurën me të cilën përfundon punësimi i një punëtori të NSH-së. Neni 219 i LPB-së përcakton se për ndërprerjen e marrëdhënies së punës, punëmarrësi duhet t'ia dorëzoj me shkrim vendimin punëtorit, duke treguar arsyet e marrjes së një vendimi të tillë, si dhe duhet të udhëzohet për të drejtat e tij për të paraqitur kundërshtimin, ndaj një vendimi të tillë andaj i janë shkelur të drejtat themelore për të ushtruar mjet juridik. Ankuesi thekson se pasi që ai nuk ishte informuar për shkaqet e ndërprerjes të marrëdhënies së punës, në bazë të dispozitave të sipërpërmendura, konsideron se ai është ende në marrëdhënie pune dhe i gëzon të gjitha të drejtat nga marrëdhënia e punës.

Sipas ankuesit, Shkalla e parë nuk i ka marrë parasysh dispozitat ligjore të nenit 221 deri në 225 të LPB-së, veqanërisht për sa i përket parashkrimit të kërkesës së paditësit.

Ankuesi thekson se pasi që punësimi i tij nuk ka përfunduar në mënyrën e përcaktuar me nenin 219 të LPBsë, duhet të konsiderohet se ai është ende i punësuar dhe i gëzon të gjitha të drejtat nga marrëdhënia e punës.

Më 25 tetor 2023 Kolegji i Apelit këtë ankesë e ka dërguar tek AKP për përgjigje. Në përgjigjen e saj të datës 09 nëntor 2023 AKP i kundërshton në tërësi pretendimet ankimore të ankuesit dhe propozon që ankesa të refuzohet dhe të vërtetohet aktgjykimi i ankimuar si i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Arsyetimi ligjor

Ankesa është e pa bazuar.

Në bazë të nenit 69.1 të Ligjit nr. 06/L-086 mbi Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (LDHP), Kolegji i Apelit vendosi të mos mbajë pjesën gojore të procedurës.

AL i AKP-së kishte refuzuar kërkesën e paditësit për shkak se kërkesa ishte parashkruar konform nenit 608 të LPB-së, derisa me aktgjykimin e ankimuar Shkalla e parë e DHPGJSK-së, ankesën e kishte refuzuar dhe e kishte vërtetuar vendimin e kundërshtuar i AL- i AKP-së, me arsyetimin se paditësi nuk ka ofruar prova në mbështetje të pretendimeve të tij, sikundër që nuk ka sqaruar bazën juridike të kërkesës, për pagat e pretenduara. Shkalla e parë kishte konstatuar se kërkesa nuk ishte parashkruar në tërësi, siç pretendon AKP, posaqërisht kërkesa prej datës 02 shkurt 2003 deri në vitin 2006 nuk është parashkruar.

Ankuesi nuk e ka të qartë se me cilat fakte është dashur që t'ia vërtetoj gjykatës aspektin e vlefshmërisë së kërkesës së tij pagat e pa paguara nga punëdhënësi. Neni 219 i LPB-së përcakton se për ndërprerjen e marrëdhënies së punës, punëmarrësi duhet t'ia dorëzoj me shkrim vendimin punëtorit, duke treguar arsyet e marrjes së një vendimi të tillë, si dhe duhet të udhëzohet për të drejtat e tij për të paraqitur kundërshtimin, ndaj një vendimi të tillë andaj i janë shkelur të drejtat themelore për të ushtruar mjet juridik. Ankuesi thekson se pasi që ai nuk ishte informuar për shkaqet e ndërprerjes të marrëdhënies së punës, në bazë të dispozitave të sipërpërmendura, konsideron se ai është ende në marrëdhënie pune dhe i gëzon të gjitha të drejtat nga marrëdhënia e punës dhe i takojnë të gjitha të drejtat nga marrëdhënia e punës.

Kolegji i Apelit ka shqyrtuar pretendimet ankimore të paditësit, aktgjykimin e ankimuar dhe provat në shkresat e lëndës dhe ka ardhur në përfundim se ankesa është e pa bazuar,

aktgjykimi i ankimuar është i saktë në rezultat dhe në arsyetimin ligjor dhe nuk janë identifikuar asnjë nga shkeljet e pretenduara nga ankuesi.

Kolegji i Apelit pajtohet në tërësi me gjetjet dhe konstatimet e Shkallës së parë edhe sa i përket aspektit të parashkrimit të kërkesës, edhe sa i përket provave që paditësi do të duhej t'i parashtronte në mbështetje të pretendimeve të tij.

Kolegji i Apelit nuk e mbështet pretendimin e ankuesit se nuk është njoftuar në mënyrë ligjore për fillimin e procedurave të likuidimit, pasi që të gjithë punëtorët ishin të njoftuar përmes shpalljes publike në gazetën zyrtare në shqip dhe serbisht. Kolegji i Apelit i konsideron si të pa sakta këto pretendime, këto pretendime.

Kolegji i Apelit konsideron se ankuesi ka qenë i vetëdijshëm se për cilat arsye është refuzuar ankesa e tij me aktgjykimin e ankimuar. Ai kishte edhe një mundësi që në fazën e ankesës para Kolegjit të Apelit të ofroj prova materiale që do i demantonte konstatimet e Shkallës së parë. Megjithatë, as në këtë fazë të procedurës ankuesi nuk ka mundur që të ofroj asnjë provë materiale, në mbështetje të pretendimeve të tij, e që do të konstatonte një gjendje tjetër faktike nga ajo që ishte konstatuar nga Shkalla e parë me aktgjykimin e ankimuar. Ankuesi nuk ka ofruar asnjë argument apo një bazë juridike që do të mund të merrej një vendim ndryshe nga ai që ishte marrë në Shkallë të parë.

Për këto arsye, ankesa e paditësit refuzohet si e pa bazuar dhe rrjedhmisht vërtetohet aktgjykimi i ankimuar i Shkallës së parë të DHPGJSK-së, si i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Nga ajo që u tha më sipër, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Taksat gjyqësore

Ankuesi në bazë të nenit 8.3.2 të Udhëzimit Administrativ të KGJK-së nr.01/2017, lirohet nga pagesa e taksës gjyqësore në procedurën ankimore, për arsye se është duke marrë ndihmë juridike nga Projekti për Ndihmë Juridike.

Lëshuar nga Kolegji i Apelit i DHPGJSK-së më 07 dhjetor 2023.

Mr.sc Sahit Sylejmani gjyqtar kryesues _____